



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLLEDHJES SË TRETË TË RREGULLT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **22.03.2019 (e Premte)**, në Zyrën e Drejtorit të Administratës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, si dhe ju të pranishëm dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e tretë të rregullt të KPF-së për këtë vit. Ju falënderojmë për pjesëmarrjen në hapjen e Flakadanit të Karadakut të organizohet për nderë të Njazi Azemit i cili ra dëshmor në vitin 2001 në luftën e UQPMB-së. A ka dikush pyetje jashtë rendit të ditës?

**z.Jakup Demiri:** Bazuar në nenin 39, paragrafi 39.1 të LVQ nr. 03/L-40, neni 7 pika 2.11 të Rregullores së KK Viti nr. 01-013/594, të datës 02/05/2014 dhe statutit të komunës së Vitisë të dates:21/04/2011 nr. 011-013/491 neni 27 paragrafi 27,1. Këshilltaret e LVV në Komunën e Vitisë kanë si propozim vendim që kompanisë private për disrtubuim dhe furnizim me energji elektrike KEDS të ju ndalohet vendosja e njësoreve për matjen e energjisë elektrike në maje të shtyllave të rrjetit elektrik në hapsirat publike në tërë teritorin e Komunës së Vitisë. Gjithashtu kam një kërkesë nga këshilltari z.Rasim Terziu, që të hynë si pikë për diskutimin edhe ndërtimi I shkollës fillore “Halil Alidema” në Pozheran.

**z.Bekim Azizi:** Kisha pas një pyetje, besoj se ndoshta nënkryetari mund me sqarua. Te objekti i partive politike ku janë atje, ka ardhur një kërkesë për renovim nga MAPL-ja. Sa do të zgjas kjo dhe çka do të bëhet renovim dhe sa do të jetë mundësia që na të kthehemi në zyre tona, për shkak të veprimtarisë dhe aktivitetit që bëhet në parti, sepse nuk kemi ndonjë informatë shtesë, përveç një kërkesë për lirim të zyrave?

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Dikush tjetër? Nëse nuk ka, ishin disa pyetje që u adresuan, nënkryetar fjala është për ju.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** janë shtruar tri çështje të cilat janë të rëndësishme së veçantë. Në radhë të parë edhe për shumë aktivitete dhe në radhë të dytë edhe për vetë qytetarët e Komunës së Vitisë dhe kjo e fundit funksionaliteti i partive të cilat funksionojnë dhe i kryen aktivitetet e veta në zyrat e tyre. Po filloj prej të parës. Po ballafaqona për herë të parë gjatë karrierës time që na vjen një propozim vendim, i cili vjen nga një subjekt politik, i cili përfaqësohet edhe në KPF edhe në Kuvend, megjithatë praktikat ligjore mund të pason si propozim, por jo edhe vendim, se vendimet dihet që i përgatit Zyra Ligjore. Si kërkesë, Jakup pajtohem plotësisht me diskutua, ndërsa për çështjen e formës së vendimit, besoj që janë zyrat tjera të cilat e përgatitin. Nëse vendosin kuvendarët, megjithatë duhet ta kemi të qartë, se iniciativa e subjekteve politike dhe qytetare mund të jetë në rast se nuk është me rregullativën na mund të diskutojmë, por nuk mundemi të qesim si propozim vendim. Na kemi pas kërkesë njëherë pse po i vendosin shumë poshtë, tash pse shumë lartë, megjithatë na duhet të marrim informacione të plota, por megjithatë do ta shikojmë çështja tjetër që e the edhe këtë mund ta bisedojmë, ne e kemi edhe planin për kryerjen e punëve në shkollën “Halil Alidema” në Pozheran. Unë konsideroj se ka afatin e fundit deri në nëntor këto brenga kanë qenë edhe tonat, ne kemi qenë edhe në ministri dhe kemi insistua që të kryhet në afatin e paraparë. Është investim i ministrive, por si informatë na do ta sjellim në kuvend, dhe dalim te Bekimi. Është e vërtetë se ne e kemi dërguar një njoftim të gjithë ata të cilët janë aty edhe tatimit në pronë edhe subjekteve politike, është një fond të cilën e kemi fituar së bashku një

përformancë e mirë e cila ka dal një shumë e grandit të cilës atij grandit ja kemi bashkangjitur me lejen e juaj të cilët jeni aprovues të kuvendit dhe e kemi shti në projekte me i rinovua objektin të cilin jemi këtu atë objekte edhe objektin i cili është i djegur vetëm këtë nuk e di, se tha Bekimi sa do të zgjatë, nuk e kam shikuar afatin. Ai objekt ka nevojë për renovim dilemë nuk ka, dhe unë kam qenë ai i cili kam kërkuar të dërgohet një njoftim paraprak, se nuk mund të lirohet brenda 10 dite të jetë një afat pak ma i gjatë që ata me pas kohë me bartë atë inventarë vetëm se e di që brenda vitit duhet me përfunduar te tirat se ma projekte dy vjeçar nuk ka.

**z.Ekrem Abazi:** Vendosija e orëmatësve, në lagjen time janë vetëm dy familje që e kanë vendosur ormatësin në shtyllë lartë. Kam pas than se janë ka na vjedhin edhe kjo kompani, se prej orës 07 deri Ora 21 punon me tarifën e shtrenjtë, ndërsa prej orës 21 deri në ora 07 në mëngjes kush mundet me nejtë punon me të lirën. Çdo vend të botës të shtunën dhe të dielen ka me tarifë të lirë, vetëm në Kosovë nuk është kjo.

**Nënkryetari z. Hasan Aliu:** Edhe diçka dua të them, se si të dal nga atakimi ka me ju drejtuar me shkresë për çka KEDS-i i vendos lartë, në çështjet në të cilat nuk i di detajet.

**z.Bekim Azizi:** Sistemi I orëve digjitale na ka dëmtuar, janë rritur shpenzimet, na në të njëjtën pike e kemi pasur me insistimin tim në legjislaturën e kaluar dhe në bazë të informative që kemi pasur asnjë leje nuk kanë pasur që I kanë vendosur nëpër shtylla, se u dashtë me marrë leje në komunë dhe pas presionit që është bërë ata e kanë ndërprerë, që mendimi imi ka qenë gabimi ma i madh që e ka shëmtuar qytetin ke edhe ora që janë kall nëpër rrugë dhe kanë qenë të dëmshme. Tash çështja e orëve të vendosura lartë, ata dyshojnë te mospagesa. Unë mendoj se këtë duhet ta konsultojmë me KEDS-in, se na mundemi me shti si pikë, na folim sa dush edhe nuk dimë asgjë nëse nuk kemi informatë që e marrim prej tjetërkuajt. E dyta, te këshilltari I Nismës. Unë jam për këtë informatë me hy, mirëpo kjo kërkesë ai ose u dashtë me protokolua poshtë ose me propozuar se është këshilltar në kuvend.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Jakup, po besoj se Bekimi e shtjelloj pak këtë çështjen e pikës së juaj. Nuk e di sa mundemi me marrë informacione, ne brenda javës që të vendosim për këtë çështje kishte qenë ma mirë na me u konsultua edhe na marrim qëndrim që për seancën e ardhshme e shtimë si pikë të rendit të ditës, si pikë ta përpunojmë mirë. Kam edhe një kërkesë nga Gazmend Hasani, i cili ka qenë anëtar i Komitetit për Aftësi të Kufizuar dhe ka marrë ndihmë sociale, këta kur e kanë parë në sistem ja kanë ndal ndihmën dhe ai kërkon që të lirohet nga kjo detyrë. Pasi nuk ka tjerë për të diskutuar, na për këtë seancë kemi paraparë këtë:

## **R e n d i t e**

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 70.000 € për pagesën e obligimit të fshatrave Goshicë dhe Gërmovë për projektin e ujësjellësit dhe kanalizimit.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit Azem Bislimi (Rrustem).**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien ne shfrytëzim pronën e paluajtshme e Komunës Vitisë në shfrytëzim afatshkurtë për ndërtimin e Shtëpisë së pleqëve në zonën kadastrale në Letnicë.**
6. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2019.**
7. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve ne vendimmarrje për vitin 2019.**
8. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit për komunitete për vitin 2019.**
9. **Propozim vendim për shkarkimin e Gazmend Hasani nga detyra e anëtarit të komitetit për persona me aftësi të kufizuara.**

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm? Pasi që nuk ka, e hedhi në votim këtë rend dite. Konstatohet se me vota unanime u miratua rendi I ditës.

Si pikë të par të rendit të ditës kemi:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**  
Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A ka dikush ju lutem rreth kësaj pike? Konstatohet se me vota unanime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë kemi:

- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019**

Ja kisha kaluar fjalën drejtorit rreth kësaj pike të rendit të ditës

**z.Ibrahim Rama:** Si zakonisht buxheti në fund vit nuk shpenzohet 100% një pjesë e mjeteve që grumbullohen në fund të vitit është e pamundur me u shfrytëzua, kështu që në bazë të ligjit që është në fuqi mbi Menaxhimin e Financave Publike, jemi të obliguar ato mjete mi bartë për vitin vijues, dhe kjo bëhet me vendim të Kuvendit Komunal. Për ma shumë e keni propozim vendimin për para. Nëse ka dikush ndonjë pyetje apo sqarim ju përgjigjem.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Faleminderit drejtor! Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

**z.Bekim Azizi:** Na e dimë tash, se ato pare në atë kod buxhetor që janë aty duhet edhe mu bartë. Po mua po më intereson kjo pike, pasi është ligjore. Na nuk mundemi me ja ndërru, se njëherë ja kemi pas ndrruar, na kthen mbrapsht, pse po e lanë si pikë kur parimisht, se edhe me votu kundër këto mjete mbesin të ngrimë, se nuk mund me ja ndërruar vendin pse na I sjellin si propozim vendim kur mundet me shku automatikisht

**Nënkryetari z. Hasan Aliu:** Gjithçka që preket t buxheti duhet kuvendi me votua.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse nuk ka tjerë për të diskutuar, unë e qes në votim që të shkoj për miratim në kuvend. Konstatohet se me vota unanime u miratua edhe kjo.

Pikë si pikë tjetër kemi:

- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 70.000 € për pagesën e obligimit të fshatrave Goshicë dhe Gërmovë për projektin e ujësjellësit dhe kanalizimit**

Ja kisha kaluar fjalën drejtorit.

**z.Ibrahim Rama:** Unë kërkoj falje, së pari se kemi një gabim teknik. I kam thanë Zyrës Ligjore si me përgatit propozim vendimin, ndërkohë nuk u kthy te unë, u shku drejt në protokoll dhe në kuvend vjen me protokoll e përmirësuar. Gabimi është se këto mjete janë të ndara vetëm për ujësjellës, aty shkruan edhe për kanalizim dmth fjala është vetëm për ujësjellës, kjo është marveshje e vitit 2009 edhe këto kanë qenë marveshje të mëhershme, por komuna është trashëgimtare e marrëveshjeve dhe obligimeve.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

**z.Jakup Demiri:** Kjo marrëveshje është mes fshatrave dhe KDI-së apo?

**z.Ekrem Abazi:** Ky ka qenë obligim I dy fshatrave dhe nuk e kanë paguar mirë, ata janë qytetar të kësaj komune, pasi ka buxhet, banë me pagu, por po pyes ka e marrin këta ujin prej cilit burim? Se po ju them, unë jam në fillim edhe shumë herë nuk kam ujë.

**z.Ibrahim Rama:** Unë po them se si është me projekt duhet me u furnizua me ujësjellës të Letnicës edhe këto dy fshatra edhe e dimë se sasia e ujit, por po shpresojmë se me ndërrimin e gypit të azbestit që pritët me u leshu shumë shpejt dhe kemi një mendim që me Hidromoraven me rritë kapacitetin e përpunimit të ujit atje në burim, përndryshe nuk ka mundësi me këtë sasi me i furnizuar edhe këto fshatra.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Unë jam si koordinator, kam pas takimin e parë dhe të dytë, I kam dhanë 15 prillin afatin e fundit sa kemi me mund me mbërru, jemi konsultu me ingjiniera, ata kanë metë me dal ne teren, kanë mbet me kqyr disa filtera të ajrit a janë në rregull, se mos me qenë ata po mujka uji me ardh deri këtu edhe këtu mu ndal. Dhe tani kyqjen e ka merr me bë Hidromorava dhe po shpresojmë në datën që e kemi vendos me u ba përrurimi.

**z.Ekrem Abazi:** A mundeni ju si Komunë, që Verbovcin dhe Genqarin mos mi lanë me u kyç. Simbas llafeve të rrugëve jo zyrtare, a mundeni mi ndalu ju si institucione komunale. Qëndroj në atë, se kam thanë, se nëse lidhen këto dy fshatra me qenë të kyqur edhe Skifteraj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi nuk ka për të diskutuar, po besoj se jeni të gjithë që të shkoj edhe kjo pikë në Kuvend.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit Azem Bislimi (Rrustem)**

Ja kisha kaluar fjalën drejtoreshës rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**znj.Majlinda Ostrogllava:** Ky është vendimi siç ka qenë edhe ma herët, vetëm se Ligji mbi Pronat e Paluajtshme nuk na lejon direkt me shku me këmbim. Vendimi i kaluar ka qenë zonë me interes, tash është këmbimi i pronës. Nëse ka dikush diçka mundem me e sqaruar?

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm. Pasi nuk ka, po e qes në votim që të shkoj në kuvend për miratim. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë.

Si pikë tjetër kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien ne shfrytëzim pronën e paluajtshme e Komunës së Vitisë në shfrytëzim afatshkurtër për ndërtimin e Shtëpisë së pëlqeve në zonën kadastrale në Letnicë**

dhe për këtë ja kisha kaluar fjalën drejtoreshës.

**Znj. Majlinda Ostrogllava:** Me këtë propozim vendim, propozohet ti jepet në shfrytëzim prona e paluajtshme Komunale në shfrytëzim afatshkurtër për ndërtimin e shtëpisë së pëlqeve në zonen kadastrale në Letnicë. Materialin e keni marrë me kohë, për pyetje, përgjigje jam në dispozicion të ju ndihmoj rreth kësaj pike.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

**znj.Gjylsime Qamili:** Një propozim vendim që me pëlqej, që për herë të parë po flitet për një shtëpi të pleqve. Më pëlqej edhe lokaliteti ku është menduar të ndërtohet kjo shtëpi, i plotëson të gjitha kushtet për një shtëpi të pleqve, por një pyetje pason për drejtoreshën çka nuk më pëlqej mua. Dua një sqarim me ma dhanë, pse është bërë me vendim 15 vite, mua nuk po më pëlqen kjo, se mbas 15 viteve çka do të veprohet. Unë po e shoh se kjo ka me dal në ankand publik, mirëpo nëse për 15 vite e ka marr qai investitor, a ka afat të caktuar kur do të filloj punën dhe çka do të veprohet, dua një informatë si do të veprohet drejtoresh.

**znj.Majlinda Ostrogllava:** Pyetje me vend edhe propozimi im ka qenë me caktuar një afat për 3 vite, nëse nuk punon prona t'i kthehet komunës. Prapë edhe për atë se pyete për 15 vite ajo i vazhdohet nëse punon si duhet.

**z.Ekrem Abazi:** Unë po mendoj se afati kohorë 15 vjeçar duhet me qenë me mundësi vazhdimi. E dyta, edhe e dyta na edhe përpara kemi dhanë, por kërkesën e ka bërë individ. Këtu nuk po shohë asnjë kërkesë me ditë kush ka bërë kërkesë edhe me shënuar aty me mundësi vazhdimi, se gjithherë kur e kemi dhanë shkruhet me mundësi vazhdimi.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Ju e dini se për shkak të vërejtjeve që na ka dhanë auditori I jashtëm, pavarësisht se vendos kuvendi, duhet me qitë thirrje publike dhe me konkurruar. Plotësisht pajtoj që kuvendi me obliguar komisionin dhe ato që I that ju, edhe unë pajtohem afati kohor për dhënien në shfrytëzim është 15 vite me mundësi vazhdimi, dhe te neni gjashtë pa shtuar nen tjetër, prona e paruajtur e qitur në shfrytëzim e përshkruar në nenin 2 të këtij propozim vendimi duhet të evidentohet në librat kadastral të komunës dhe shfrytëzuesi obligohet që brenda 2 vite të filloj punimet. Na jemi takuar, me të jeton në Amerikë edhe ka parë atje edhe po donë me ba një investim. Këtu ai ka një parcelë afër, po nuk i mjaftojke edhe besoj se edhe Vitia ka nevojë për një shtëpi të tillë.

**z.Ekrem Abazi:** Siç po e thuani ju serioz këtë njeri, unë mendoj as dy vite mos me ja lanë vetëm një vit me filluar që të shohim se u dha një vendim prej kuvendi dhe filloi me u jetësua.

**z.Jakup Demiri:** Na mundemi me ja përcaktuar, me filluar brenda 1 viti mundemi edhe përfundimin brenda 3 viteve, se çka banë ai është punë e tij dhe me lanë një aneks nëse nuk I përfundon në këtë periudhë kohore me ja dhanë ndonjë vërejtje.

**z.Bekim Azizi:** Në këtë lëmi pak kam informata, por jam shumë skeptik, se plaku nuk shkon hiq në Letnicë atë gajle po javë heki. Na në çerdhe s'janë ka I qojnë shumë e po I qojnë në shtëpi të pleqve. Por, këtu duhet të diskutohet a duhet të jetë një shpi e pleqve apo do të jetë vetëm një qëndrim ditor. Duhet me ditë a është me qëndrim të përhershëm. Nëse jepet prona për një shtëpi të pëlqeve dhe shfrytëzohet për tjera, se unë mendoj se ato duhet të jenë të kufizuara.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë po e qes në votim që të shkoj në miratim në kuvend, Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend me përmirësimet që u kërkuan.

Tash i kemi tri pika të rendit të ditës që kanë karakter të njëjtë:

**7. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje për vitin 2019**

**8. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit për komunitete për vitin 2019.**

**9. Propozim vendim për shkarkimin e Gazmend Hasani nga detyra e anëtarit të komitetit për persona me aftësi të kufizuara.**

Para se me hap debat, unë dua t'i falënderoj që naj kanë sjell një plan të punës. A donë ta merr fjalën dikush?

**z.Ekrem Abazi:** Kështu kur e lexon shumë mirë, por ju si komunë çka keni bërë për ta, a e keni punësuar ndonjë person me aftësi të kufizuara, por ka person me aftësi të kufizuara, se edhe me dashtë me punu nuk mundet, por duhet ndonjë familjarë të tyre.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Në fuqinë time që e kam e kam shpre dhe kam thanë, se e kemi obligim moral e shpirtëror.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Po Ekrem, kemi punësuar një rast, që sot I paska vdek ai djali, e ka pas një fëmijë të paralizuar 27 vite, e kemi marr korrir në shkollë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Shumë e vërtet, bile i kemi pas ngul këmbë që me ardhur ky vetëm për këtë rast që e ka pas në familje. Nëse nuk ka tjetër edhe këto dy pika tjera që janë të njëjta dhe atë që e propozoj Jakupi, fillimisht rreth njësoveve elektrik. A jeni që të shkojnë edhe këto pika në Kuvend? Konstatohet se me vota unanime shkojnë në kuvend. Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundon në ora: 11:20

**Procesmbajtësi:  
Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë  
z.Naim Pira**

---